



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

RAPORTI I MONITORIMIT 12-MUJOR I 2020

M I R A T O I

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Lorin YMERI

Gëzim KALLAJXHI

Ili SADO

**DHJETOR 2020
ADISA**

Tabela e përmbajtjes

I.	Hyrje	3
II.	Qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës.	3
	A. Treguesit e performancës ne nivel qëllimi	4
	B. Treguesit e performancës në nivel objektivi	4
III.	Buxheti i miratuar dhe faktik për vitin 2020.....	15

I. Hyrje

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) është person juridik publik, i organizuar në formën e agjencisë autonome të krijuar me Ligjin nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 88, datë 18.12. 2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe mbështetur në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” po Ju paraqesim raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2020. Në realizimin e këtij raporti Ekipi i Menaxhimit të Programit ka bërë monitorimin e vazhdueshëm nëpërmjet procesit të vlerësimit dhe krahasimit të treguesve faktik të performancës me ata të planifikuar. Ky raport në vijim është miratuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Qëllimi i këtij monitorimi ishte ndjekja e vazhdueshme e arritjes së objektivave të synuar të përcaktuar tashmë në deklaratën e programit “Transformimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve në Shqipëri përmes qasjes me në qendër qytetarin duke realizuar ndarjen funksionale dhe integrimin e shërbimeve publike në sportel, zhvillimin e kanaleve të ofrimit të shërbimeve, marrjen e opinionëve të qytetarëve dhe monitorimin e lëvrimin të shërbimeve të standardizuara.”

Në përfundim të këtij raporti, informacioni i marrë shërbeu për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit për periudhën në vijim. Ekipi i Menaxhimit të Programit ka kryer monitorimin e objektivave bazuar në treguesit e performancës, në sasi dhe vlerë për produktet, si një proces që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse.

Në vijim të këtij raporti do të gjeni një informacion të hollësishëm, të problematikave, mangësive të vërejtura, ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave të politikës, realizimin e produkteve krahasuar me planin në terma sasiorë dhe cilësorë shoqëruar me argumentet përkatës, konkluzionet si dhe propozimet konkrete për periudhën në vijim në lidhje me ndryshimet për rishikimin apo jo të politikës së programit apo propozime të tjera për përmirësimin e situatës.

II. Qëllimet, objektivat dhe treguesit e performancës.

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) ka vijuar me kryerjen e shpenzimeve buxhetore brenda programit të vetëm buxhetor me emërtesën: “**Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike**” ku përfshihet buxheti i miratuar dhe akorduar për vitin buxhetor 2020, i ndarë sipas artikujve ekonomikë.

Nëpërmjet këtij programi synohet konsolidimi i rregullave për ofrimin e shërbimeve publike të integruara ndaj publikut në mënyrë të drejtë për drejtë, nëpërmjet sporteleve në Qendrat e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, përmes heqjes së pengesave administrative dhe ofrimit të shërbimeve në mënyrë të shpejtë, efikase, transparente dhe me cilësi të lartë.

Për matjen e performancës së programit nga Ekipi i Menaxhimit të Programit janë evidentuar dhe matur treguesit në nivel qëllimi dhe treguesit në nivel objektiv, si me poshtë vijon:

A. Treguesit e performancës ne nivel qëllimi

1. Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara;
2. Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike;
3. Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve në sportelet ADISA;

Realizimi i tyre paraqitet në tabelën më poshtë:

Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	Plan	Fakt	% Realizimit
Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara	441	436	99%
Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike	427/1300	820/1300	192%
Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve në sportelet ADISA	77%	99%	132%

B. Treguesit e performancës në nivel objektiv

1. Numri i Qendrave/Njësive te Ofrimit te Sherbimeve Publike te Integruara;
2. Numri i Bashkive (jo qendër-qarku) në të cilën ADISA është prezent nëpërmjet sporteleve të saj;
3. Numri i njësive lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike;
4. Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike;
5. Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike;
6. Matja e kohës së shërbimit në sportelet pritëse

Realizimi i tyre paraqitet në tabelën më poshtë:

Treguesit e Performancës në nivel Objektiv	Plan	Fakt	% realizimit
Numri i Qendrave/Njësive te Ofrimit te Sherbimeve Publike te Integruara	11	9	82%
Numri i Bashkive (jo qendër-qarku) në të cilën ADISA është prezent nëpërmjet sporteleve të saj	11	11	100%
Numri i njësive lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike	0	0	0%

Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike ndaj totalit të shërbimeve publike	1120/1300	1134/1300	101%
Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike	360	354	98%
Matja e kohës së shërbimit në sportelet pritëse. *	4'	9'	NA

* Koha faktike e matur në sportelet pritëse ADISA nuk i referohet më aplikimit të marrë nga sportelistët por asistimit të qytetarëve në kryerjen e aplikimit online në portalin e-albania. Si pasojë e këtij ndryshimi në procesin e punës nuk mund të aplikohet përqindja e realizimit.

Më poshtë po Ju paraqesim një argumentim të shkurtër të vlerave të realizimit të vendosura nga ana jonë, si më poshtë:

- Treguesi A.1 - Numri i shërbimeve të ri-inxhinieruara.

Një pjesë e rëndësishme e financimit të Bankës Botërore lidhet me procesin e ri-inxhinierimit të shërbimeve publike. Tashmë që kjo reformë është drejt përfundimit, është përgatitur një raport vlerësimi gjithëpërfshirës mbi zbatimin e rekomandimeve të ri-inxhinierimit për një grup shërbimesh publike. Për të kryer këtë vlerësim ADISA përzgjodhi një kompani ndërkombëtare, e cila u asistua nga ADISA gjatë procesit.

Gjatë procesit të vlerësimit u mblodhë informacion nga palët e interesuara dhe u kërkua mendimi i tyre lidhur me dobinë e rekomandimeve të ri-inxhinierimit, sa ato kanë shërbyer si parime bazë për reformimin e shërbimeve publike, si edhe për të parë mundësinë për reforma të tjera të ngjashme në të ardhmen. Fokusi i vlerësimit ishte zbatimi i reformës së Ri-inxhinierimit dhe u përqendrua në progresin dhe rezultatet e arritura (pra identifikimi i problematikave apo mangësive të mundshme nuk janë në fokusin e vlerësimit).

Institucionet e përfshira në këtë proces validimi ishin: Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit (AQTN), Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD), Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), Qendra e Shërbimeve të Arsimit (QSHA). Gjatë periudhës raportuese janë kryer intervista të thelluara dhe diskutimeve profesionale me grupet e punës të ngritura në secilin nga institucionet e sipërcituara. Për çdo shërbim publik në fokus të këtij vlerësimi, janë kryer intervista të dedikuara (ose disa intervista në rastet kur ka qenë e nevojshme, në varësi të numrit të shërbimeve që janë për t'u vlerësuar).

Bazuar në këtë analizë, mëposhtë përmirësimet sipas indikatorëve për 70 shërbimet e analizuar:

- Koha e dhënies së shërbimit u përmirësua në 44% të shërbimeve
- Numri i dokumenteve që duhet të paraqesë kërkuesi u reduktua në 87% të shërbimeve
- Numri i hapave të zyrës mbështetëse u reduktua në 77% të shërbimeve

Të paktën një komponentë është përmirësuar në 14% të shërbimeve, dy të tillë janë përmirësuar në 63% të shërbimeve dhe të komponentët janë përmirësuar në 23% të tyre.

Thuajse 60% e shërbimeve të marra në analizim janë plotësisht online, d.m.th., qytetari nuk ka më nevojë të paraqitet pranë zyrave pritëse të shërbimit. Materiali dërgohet me postë ose si dokument elektronik.

Adresa: Bulevardi "Zhan d 'Ark ", ish-Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Shqipëri

E-mail: informacion@adisa.gov.al

Për shërbimet e analizuara, 63% e rekomandimeve për përmirësime relevante janë zbatuar plotësisht ose në formë të modifikuar:

- 60,82% të reformave BPR të rekomanduara janë zbatuar sipas propozimit
- 2,22% e reformave BPR janë miratuar në formë të modifikuar

Vlen të theksohet se gjatë reformës së BPR, qeveria shqiptare ka miratuar disa dokumente ligjore që prekin të gjitha kategoritë e shërbimeve dhe mënyrën e ofrimit të tyre sot dhe ka krijuar bazat për përmirësimet në shërbimet publike gjatë viteve të fundit. Këta janë:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 495, 13.09.2017 – për vlefshmërinë dhe veçoritë (nënshkrimin dhe vulën elektronike) të dokumenteve elektronike administrative;
2. Urdhri i Kryeministrit nr. 158, 25.11.2019 – urdhri i përgatitjes së institucioneve për aplikimin online të shërbimeve të tyre duke filluar nga 01.01.2020;
3. Urdhri i Kryeministrit nr. 43, 15.01.2020 – për qarkullimin e dokumenteve me SQDNE.

Si përfundim, të 70 shërbimet e marra në vlerësim në këtë Raport Përfundimtar janë përmirësuar në masë të konsiderueshme. Banka Botërore bazuar në arritjet e reformës së Ri-inxhinierimit miratoi disbursimin e pjesës përkatëse të huasë.

➤ Thjeshtëzimi dhe optimizimi i procedurave dhe dokumentacionit për shërbimet publike

Në kuadër të prioritetit të Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e shërbimeve publike, thjeshtëzimin, optimizimin e procedurave dhe dokumentacionit si dhe në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr.158, datë 25.11.2019 prej Janarit 2020 një numër i konsiderueshëm i shërbimeve publike, 750 prej tyre tashmë ofrohen online në portalin qeveritar e-Albania.

ADISA për vitin 2020 ka asistuar në ri-inxhinierimin e shërbimeve publike të ALUIZNI-t, Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe AZHBR-së.

Në zbatim të Vendim nr. 389, datë 13.5.2020 të Këshillit të Ministrave si dhe ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, tashmë 4 shërbimet e ALUIZNI-t janë eliminuar nga lista e shërbimeve të ASHK-së. Të gjitha shërbimet e ASHK-së ofrohen online, ky një prej rekomandimeve të ri-inxhinierimit. Përsa i takon shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit tashmë ofrohen online 2 nga 3 shërbimet publike që ofron ky institucion. Shërbimi i tretë për shkak të natyrës nuk mund të ofrohet online. Gjatë vitit 2020 janë rivaliduar shërbimet e AZHBR duke e çuar në nga 10 në 6 numrin e shërbimeve të ri-inxhinieruara për këtë institucion me kalimin e tyre plotësisht online.

Në total në procesin e ri-inxhinierimit gjatë vitit 2020 janë përfshirë 12 shërbime publike duke e çuar totalin e shërbimeve të ri-inxhinieruara në 436.

Ndërkohë që sipas planifikimit buxhetor afatmesë (2020 – 2022), ishin parashikuar 17 shërbime për vitin 2020 duke e çuar totalin në 441 shërbime të ri-inxhinieruara. Duke qenë se listat e shërbimeve pësojnë ndryshime të shpeshta pasi kalojnë procesin e rivalidimit, është vështirë që parashikimi të përputhet plotësisht me realizimin. Institucionet e parashikuara për vitin 2020 ishin: ALUIZNI (4 shërbime), DPP përmbartimi (3 shërbime) dhe AZHBR (10 shërbime) dhe realizimi ishte: ALUIZNI (4 shërbime), DPP përmbartimi (2 shërbime) dhe AZHBR (6 shërbime) për arsytet e shpjeguara më lart.

- Verifikimi i proceseve të punës për ofrimin e shërbimeve publike

Gjatë vitit 2020, ADISA ka qënë e angazhuar në popullimin e Platformës së Inventarizimit të Shërbimeve Publike (ISHP). Kjo Platformë është konceptuar si një ndërveprim mes institucionit dhe ADISA për shkëmbim të dhënash mbi shërbimet publike dhe mbledhjen e informacionit mbi afatet ligjore, tarifin, ku mund të aplikohet si dhe informacione të tjera për procedurat BO, të cilat do të përdoren në momentin kur institucionit do t'i nënshtrohen procesit të ri-inxhinierimit të shërbimeve publike. Informacioni i mbledhur nga Platforma ISHP do të shërbejë për të ndjekur në vijim procesin e ri-inxhinierimit të shërbimeve publike dhe standardizimit të shërbimeve publike, duke gjeneruar Kartelat Informative, si dhe Formularët e Aplikimit.

Sa më sipër, e në vijim të bashkëpunimit ndër-institucional, ADISA është angazhuar në 3 faza, përkatësisht: (i) prezantimi i Platformës tek institucionet publike, (ii) Validimi i listës së shërbimeve dhe (iii) plotësimi i Platformës.

Gjatë vitit 2020 ka vijuar procesi i bashkëpunimit me AZHBR-në, me të cilin është validuar lista e shërbimeve në bazë të VKM-së nr. 100, datë 05.02.2020 për Skemat Kombëtare si dhe janë plotësuar rubrikat në platformë për 7 shërbimet publike që ofron ky institucion. Ndër to 6 shërbime ofrohen nëpërmjet portalit e-Albania, ku ADISA asiston fermerët për aplikim si dhe ofron informacion nëpërmjet Qendrës së Informimit për Shërbimet Publike ADISA.

Gjatë vitit 2020 është rivaliduar lista e shërbimeve publike që ofron Agjencia Shtetërore e Kadastrës, pasi ka pësuar ndryshime në zbatim të Vendim nr. 389, datë 13.5.2020 të Këshillit të Ministrave si dhe ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”. Më pas janë përditësuar të dhënat në platformë për të 65 shërbimet publike që ofron ky institucion. Fushat e përditësuara janë në bazën ligjore, afatet ligjore, tarifin si dhe kanali i lëvrimin të shërbimit.

- Treguesi A.2 - Numri i shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ndaj totalit të shërbimeve publike.

Sportelet e Zyrrave Rajonale/Vendore ADISA ofrojnë asistencë për rreth 750 shërbimet publike të pushtetit qendror dhe 70 të tilla të pushtetit vendor që aplikohen nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, për një total prej 820 shërbimesh.

ADISA gjatë periudhës raportuese ka qënë e angazhuar në hartimin dhe negociimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e administratës publike për përmirësimin e procesit të aplikimit për shërbimet publike edhe në rastet kur këto shërbime nuk janë online. Në këtë kuadër është nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Prej muajit Janar 2020 qytetarët mund të aplikojnë për këtë shërbim në të gjitha Zyrat ADISA kur më parë aplikohesh vetëm në sportelet e ASCAL në Tiranë.


Gjithashtu në sportelet ADISA ofrohen dhe shërbime publike, të cilat nuk ofrohen online nëpërmjet portalit e-albania.

Sipas planifikimit buxhetor afatmësë (2020 – 2022), për vitin 2020 ishin parashikuar 427 shërbime në total në Qendrat ADISA (me shtimin e 9 shërbimeve të QPP dhe 3 shërbime të QKIPK), ndërkohë që nga Janari 2020 shumë shërbime kaluan online duke e çuar totalin e shërbimeve në Qendrat ADISA në 820 shërbime. Bërja e shërbimeve online ndikoi në rritjen e menjëhershme të numrit të shërbimeve të ofruara në Qendrat ADISA si dhe tejkaloi parashikimin.

- **Treguesi A.3- Rritja e kënaqësisë së qytetarëve në marrjen e shërbimeve të ofruara nga Qendrat e Integruara ADISA**

Gjatë vitit 2020 janë realizuar matjet e kënaqësisë qytetare pranë Zyrës Rajonale Tiranë 1 (Shkurt 2020), “One Stop Shop” Librazhd (Mars, Qershor), Zyrës Rajonale Fier (Qershor), Zyrës Vendore Lushnje (Korrik), “One Stop Shop” Divjakë (Korrik), Zyra Rajonale Tirana 2 (Shtator), Zyra Vendore Krujë, Zyra Rajonale Shkodër dhe Zyra Vendore Kavajë (janë realizuar gjatë muajit Tetor) dhe Zyra Rajonale Gjirokastrë (Nëntor).

Më poshtë paraqitja grafike e realizimit të sondazheve të drejtpërdrejta:



Nga grafiku më lart, vihet re që mesatarja e qytetarëve të kënaqur dhe shumë të kënaqur në Qendrat ku u zhvilluan sondazhet e matjes së kënaqësisë është 99%. Sipas planifikimit buxhetor afatmesë (2020 – 2022), kënaqësia për vitin 2020 ishte parashikuar në nivelin 77% (kjo duke u nisur nga niveli i kënaqësisë në sportelet e institucioneve përpara hapjes së Qendrave ADISA), fal kushteve me standarde Europiane dhe aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë niveli mesatar i kënaqësisë arriti në 99%.

- **Treguesi B.1 – Numri i Qendrave/Njësive te Ofrimit te Sherbimeve Publike te Integruara.**

ADISA numëron 9 (nëntë) qendra të integruara të ngritura në rang vendi, përkatësisht në Tiranë, Kavajë, Fier, Krujë, Gjirokastrë, Shkodër, Kombinat, Lushnje dhe Elbasan.

Në Janar të këtij viti u inaugura qendra e integruar ADISA Lushnje me 14 sportele fizike në të cilat asistohen qytetarët për shërbime publike të ofruara nëpërmjet portalit qeveritar e-albania. Qytetarët e bashkisë Lushnje dhe zonave përreth, tani mund të asistohen edhe për përcjelljen e ankesave nëpërmjet portalit ShqipëriaQeDuam.al. Për më tepër, qendra ADISA Lushnje ofron rreth 68 shërbime vendore të bashkisë si dhe shërbime të Postës Shqiptare ku mund të kryhen edhe veprime financiare.



Gjithashtu në Qershor të këtij viti u inaugura qendra e integruar ADISA në bashkinë Elbasan në të cilën asistohen qytetarët për të gjitha shërbimet publike që ofrohen nëpërmjet portalit qeveritar e-albania në 18 sportele fizike. Qytetarët e bashkisë Elbasan dhe zonave përreth, tani mund të asistohen edhe për përcjelljen e ankesave nëpërmjet portalit ShqipëriaQeDuam.al. Për më tepër, qendra ADISA Elbasan ofron rreth 60 shërbime vendore të bashkisë si dhe shërbime të Postës Shqiptare ku mund të kryhen edhe veprime financiare.



Përgjatë vitit 2020 ishte planifikuar gjithashtu shtrirja në territor nëpërmjet qendrave të integruara edhe në bashkitë Kamëz dhe Vlorë, duke e çuar më tej në 11 numrin e qendrave ADISA brenda këtij viti.

Për shkak të situatës së krijuar prej pandemisë, punimet në qendrat e sipërpërmendura janë shtyrë dhe aktualisht godina e përzgjedhur për qendrën ADISA Kamëz është në proces rikonstruksioni dhe parashikohet të përfundojë dhe të jetë funksionale brenda vitit 2021.


Përsa i përket godinës së përzgjedhur në bashkinë Vlorë, si pasojë e tërmetit të Nëntorit 2019, projektuesi ka vlerësuar se godina ka amortizim të theksuar dhe për këtë arsye u krye një vlerësim i thelluar i cili përcaktoi formën e punimeve të cilës do të duhet t'i nënshtrohet. Pas rezultateve të vlerësimit të thelluar, ADISA do të marrë në dorëzim projektin e rikonstruksionit të godinës, për të vazhduar më pas me punimet të cilat nuk mundën të realizoheshin brenda vitit 2020 siç ishte planifikuar por do të vijojnë përgjatë vitit 2021.

- Treguesi B.2 – Numri i Bashkive (jo qendër-qarku) në të cilën ADISA është prezent nëpërmjet sporteleve të saj.

Përveç qendrave të integruara, ADISA vijon planin e shtrirjes në të gjithë territorin e Shqipërisë edhe nëpërmjet sporteleve të saj në bashkitë jo qendër-qarku. Nëpërmjet ekranit të dyfishtë, në këto sportele asistohen qytetarët në procesin e aplikimit për shërbime publike përmes portalit qeveritar e-albania si dhe për përcjelljen e ankesave nëpërmjet portalit ShqipëriaQeDuam.al. Vlerë e shtuar për qytetarët e bashkive në të cilat është prezentë ADISA nëpërmjet sporteleve të përbashkëta me bashkitë, është ofrimi i shërbimeve vendore dhe qendrore në një vend të vetëm në ambiente bashkëkohore të standardeve Evropiane, me sistem elektronik të menaxhimit të radhës dhe infrastrukturë të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara..

Aktualisht ADISA është e pranishme në 11 (njëmbëdhjetë) bashki jo qendër qarku: Maliq, Belsh, Patos, Librazhd, Divjakë, Malësi e Madhe, Kukës, Pogradec, Mat, Roskovec dhe Kolonjë.

Në Korrik të këtij viti, ADISA çeli zyrën me një ndalesë në bashkinë Pogradec në të cilën ofrohen mbi 750 shërbime publike nëpërmjet portalit qeveritar e-albania. Tashmë qytetarët e bashkisë Pogradec nëpërmjet 10 sporteleve fizike, do të asistohen dhe informohen për të gjitha shërbimet publike dhe vendore të bashkisë.



Gjithashtu gjatë muajit Gusht është operacionalizuar zyra me një ndalesë në bashkinë Mat në të cilën ofrohen mbi 750 shërbime publike nëpërmjet portalit qeveritar e-albania. Nëpërmjet 5


sportelevë të dedikuara, qytetarët mund të asistohen dhe informohen për të gjitha shërbimet publike dhe vendore të bashkisë Mat.



Që prej shtatorit të vitit 2020 ka nisur funksionimin zyra ADISA Roskovec duke i asistuar qytetarët e kësaj bashkie dhe zonave përreth për të gjitha shërbimet e ofruara online nëpërmjet portalit e-albania dhe gjithashtu për shërbimet vendore të Bashkisë. Në dispozicion të qytetarëve, ADISA Roskovec ka vendosur 11 sportele fizike në të cilat mund të ofrohet shërbim dhe informacion për mbi 1000 shërbime publike.



Prej nëntorit të vitit 2020 ka nisur funksionimin zyra ADISA Kolonjë duke i asistuar qytetarët e kësaj bashkie dhe zonave përreth për të gjitha shërbimet e ofruara online nëpërmjet portalit e-albania dhe gjithashtu për shërbimet vendore të Bashkisë. Në dispozicion të qytetarëve, ADISA Kolonjë ka vendosur 4 sportele fizike në të cilat mund të ofrohet shërbim dhe informacion për mbi 1000 shërbime publike.



- **Treguesi B.3 – Numri i njësive lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike.**

Për të siguruar akses edhe në ato Njësi Administrative të konsideruara si zona të thella apo rurale, ku në shumicën e rasteve janë prezentë vetëm zyrat e gjendjes civile, gjithashtu duke marrë parasysh faktin se fluksi i transaksioneve në këto zona nuk e justifikon praninë e ADISA si me qendër të integruar apo me sportele One Stop Shop pranë zyrave të bashkive, një mënyrë alternative dhe inovative e pilotuar që prej tetorit të 2019 ka qenë Zyra Lëvizëse ADISA. Fillimisht zyra lëvizëse është pilotuar në qarkun e Tiranës, në njësitë administrative të Zall-Herit, Shëngjergjit dhe Baldushkut.

Gjatë fillimit të këtij viti, prej situatës së shkaktuar prej pandemisë dhe pamundësinë për të respektuar distancimin social, u ndërpre përkohësisht asistenca për shërbime publike në zona të thella rurale nëpërmjet zyrës lëvizëse.

Gjatë periudhës së pandemisë, ADISA i është bashkuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtje Sociale duke bashkuar forcat në luftën kundër Covid-19. Nëpërmjet zyrës lëvizëse, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë, ke kryer teste për Covid-19 edhe për banorët të cilët ndodhen në zona të thella rurale dhe nuk kanë mundësi akses në qendrat shëndetësore.

Tashmë pas fazës së pilotimit dhe ndryshimit të qasjes së ofrimit të shërbimeve publike vetëm online, do të vijohet me strategji të tjera në zona të thella rurale dhe njësia lëvizëse do t'i paraprijë ngritjes së qendrave të reja ADISA.

- **Treguesi B.4 – Numri i kartelave informative të standardizuara për shërbimet publike (Janar – Dhjetor 2020)**

Përgjatë vitit 2020, ADISA ka hartuar 61 kartela informative për 5 institucione. Konkreisht për Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Ministria e Rurizmit dhe Mjedisit.

Numri i kartelave të standardizuara nga ADISA është *1134 për 63 institucione* publike, nga të cilat 1090 kartela informative janë përpiluar sipas platformës ISHP, ndërsa 37 përpara krijimit të kësaj platforme.

Në kuadër të standardizimit të kartelave informative, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, janë bërë përditësime të vazhdueshme në brendinë e informacionit për rubrikat e shërbimeve publike, referuar ndryshime ligjore të bëra nga institucionet si dhe automatizimit të shërbimeve, uljen e numrit të dokumenteve, kanalet e lëvrimit dhe përfitimit të shërbimeve, etj.

KARTELA INFORMATIVE TË HARTUARA (JANAR – DHJETOR 2020)		
Nr	Institucioni	Kartela
1	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)	7
2	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	24
3	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	2
4	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)	21
5	Ministria e Rurizmit dhe Mjedisit	7
	TOTALI	61

- **Treguesi B.5 – Numri i formularëve të aplikimit, të standardizuar për shërbimet publike.**

Gjatë kësaj periudhe, ADISA ka hartuar *19 formularë të rinj* për *6 institucione*. Konkreisht për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF), Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe për Enti Kombëtar i Banesave (EKB).

Numri total i formularëve të aplikimit të standardizuar është *354 për 47 institucione*, nga të cilët, *241 formularë të 32 institucioneve* janë në përdorim dhe mbulojnë *396 shërbime*.

Nisur nga objektivi vendosur prej 360 formularësh për vitin 2020, ADISA, ka kapur shifrën e 354 formularëve, një realizim prej 98 përqind. Formularët e standardizuar përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020, janë si në tabelën më poshtë:

Formularë aplikimi të standardizuar në periudhën Janar – Dhjetor 2020

Nr.	Institucioni	Formularë
1	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)	5
2	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)	1
3	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)	4
4	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	1
5	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)	5
6	Enti Kombëtar i Banesave (EKB)	3
	TOTALI	19

- Treguesi B.6 – Matja e kohës së shërbimit në sportelet pritëse.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 janë realizuar matjet e kohës në Qendrat e Integuara si në tabelën e mëposhtme. Nga matjet e kryera, rezulton se për një qytetar Koha e aplikimit është mesatarisht 19 minuta në Zyrën Rajonale Tirana 1, 8 minuta në Zyrën Rajonale Tirana 2, 4 minuta në Zyrën Rajonale Gjirokastrë, 8 minuta në Zyrën Rajonale Shkodër, 7 minuta në Zyrën Vendore Krujë, 12 minuta në Zyrën Vendore Lushnje, 7 minuta pranë “One Stop Shop” Divjaka, 11 minuta në Zyrën Rajonale Fier dhe 13 minuta pranë “One Stop Shop” Librazhd.

Më poshtë paraqiten të dhënat më të detajuara për secilën nga Qendrat e Integuara:

Zyra Rajonale/Vendore	Koha e Aplikimit
Tiranë 1	19 min*
Tiranë 2	8 min
Gjirokastrë	4 min
Shkodër	8 min
Krujë	7 min
Lushnje	12 min
Divjakë	7 min
Fier	11 min
Kavajë	8 min
Librazhd	13 min

* Koha faktike e matur në sportelet pritëse ADISA nuk i referohet më aplikimit të marrë nga sportelistët por asistimit të qytetarëve në kryerjen e aplikimit online në portalin e-albania. Dhe duke qenë se në qendrën Tirana 1 sondazhet janë kryer në fillim të vitit pra ishte periudha fillestare e ndryshimit të aplikimit kur kishte shumë probleme të funksionimit të sistemit të cilat bënë që koha e aplikimit të jetë shumë e lartë dhe jo reale.

Gjatë vitit 2020 si pasojë e ndryshimit të mënyrës së aplikimit nga matjet e kryera (si në tabelën më sipër) ka rezultuar një rritje e lehtë e kohës së aplikimit, krahasuar me një vit më parë. Koha mesatare e aplikimit në Qendrat ADISA për vitin 2020 është 9 minuta si pasojë e ndryshimit të sitemit të aplikimit. Sipas planifikimit buxhetor afatmesë (2020 – 2022), koha mesatare e aplikimit për vitin 2020 ishte parashikuar 4’ duke u referuar në mënyrën e vjetër të aplikimit në sistemet e institucioneve, ndërkohë që me berjen e aplikimeve vetëm online kjo kohë ndryshoi.

III. Buxheti i miratuar dhe faktik për 12 mujorin e vitit 2020


000/lekë

Buxheti 2020	Plan ¹	Fakt	% realizimit
Paga	114,541	105,246.42	92%
Sigurime Shoqërore	18,819	17,497.988	93%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	27,752	27,738.179	100%
Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	50,000	21,861.049	44%
Shpenzime Kapitale me financim të huaj ²	98,746	118,316.059	119%

¹ Për zërin “Paga”, buxheti i miratuar në fillim ishte 135,541 mijë lekë. Gjatë vitit, ky fond është pakësuar me 25,000 mijë lekë. Konkretisht, sipas aktit normativ nr. 28, datë 02.07.2020, ku plani i buxhetit për llogarinë ekonomike 600 (Paga) është pakësuar me 10,000 lekë, duke vijuar me aktin normativ nr. 15, datë 24.04.2020, me një pakësim prej 5,000 lekë. Bazuar në nevojën për mbulimin e shpenzimeve operative, ADISA ka kërkuar transferimin e fondeve të lira nga llogaria ekonomike 600 (për shkak të vakancave) në llogarinë ekonomike 602 më një shumë prej 10,000 mijë lekë, kërkesë e cila është aprovuar nga shkresa e MFE në datën 14.08.2020 me nr. 663/1 Prot. Si pasojë e të gjitha pakësimeve gjatë vitit, zëri “Paga”, rezulton në plan buxhet me vlerën e shkruar në tabelë.

Për “shpenzimet kapitale me financim të brendshëm”, fondet e miratuara në fillim të vitit 2020 ishte 70,000 mijë lekë dhe në zbatim të Aktit Normativ nr. 28., datë 02.07.2020 u miratua pakësimi prej 20,000 mijë lekë mbi fondin e buxhetuar fillimisht.

²Finacimi i huaj për projektin “Për ofrimin e Shërbimeve Publike me në Qendër Qytetarin” nuk i nënshtrohet procedurave standarte të thesarit, pasi fondet e huase nga Banka e Shqipërisë kalojnë në bankën e nivelit të dytë, prej nga ku procesohen pagesat për shërbimet e marra nga të tretet, duke mos kaluar nga sistemi i thesarit. Kjo shpjegon tejkalimin e vlerës plan të thesarit për vitin 2020.



Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) është realizuar në përputhje me strukturën, si dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për trajtimin me paga të punonjësve. Siç shikohet dhe nga shifrat e vendosura në tabelë, kemi një realizim të kënaqshëm të këtyre dy treguesve, duke mundur plotësimin e plotë të nevojave për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Shumat e realizuara për periudhën e raportimit janë përkatësisht 105,246.42 mijë lekë për artikullin 600 dhe 17,497.988 mijë lekë për artikullin 601, që përkthehen në një realizim prej 92% dhe 93% të zërave respektive ndaj totalit të planifikuar për 12 mujorin. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktik së të punësuarve gjatë periudhës së raportimit si dhe pagesave respektive, si dhe fakti që disa punonjës janë me leje barrë lindje dhe paguhen nga fondi i sigurimeve shoqërore. Numri faktik i punonjësve të punësuar në fund të muajit Dhjetor 2020 është 163 persona. Brenda këtij numri janë përfshirë edhe 8 punonjës me leje lindje. Gjatë vitit 2020 janë punësuar si personel me kohë të plotë 39 punonjës dhe 4 praktikantë. Të larguar nga puna gjatë kësaj periudhe kanë qenë 33 punonjës.

Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime (zëri 602), është realizuar në vlerën 27,738.179 mijë lekë ose 100% të totalit. Procedurat për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit vjetor, janë realizuar nga komisioni përkatës në përputhje të plotë me ligjin e prokurimit publik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Shpenzimet janë kryer periodikisht, sipas faturave të dorëzuara. Fondi i realizuar përfshin pagesat për procedurat e prokurimit për blerje, “Dietat brenda vendit”, “Shpenzime energji elektrike”, “Shërbim roje private”, “Shërbim postar”, “Shërbim telefoni”, “Shërbim mirëmbajtje automjeti”, “Siguracion automjeti”, “shpenzime për ujësjellës kanalizime”, etj.

Fondi për Investime të brendshme (zërat 230+231), është i detajuar:

1. Rikonstrukcioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Elbasan 21,143.574 mijë lekë, realizuar në masën 100%. Ky investim ka përfunduar dhe është kryer edhe pagesa në vlerë 21,141 mijë lekë.
2. Mbikëqyrje punimesh për Rikonstrukcionin e Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Elbasan në shumën 653.83 mijë lekë, realizuar në masën 100%.
3. Kolaudim punimesh për Rikonstrukcionin e Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Elbasan në vlerën 71.19 mijë lekë, realizuar në masën 100% në vlerën 66 mijë lekë.
4. Rikonstrukcioni i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike Kamëz në masën 28,131.40 mijë lekë. Ky fond nuk është realizuar si pasojë e pezullimit të procedurës së prokurimit.

Fondi për Investime të huaja (zërat 230+231), është miratuar në shumën 98,746 mijë lekë. Financimi i huaj është i detajuar sipas regjistrit të prokurimeve të miratuar nga Banka Botërore. Nga ky fond janë realizuar në masën 36,814.956 mijë lekë ose 37.28% artikulli 230 dhe artikulli 231 në shumën 81,501.103 mijë lekë ose 82.5%. Në total fondi i investimeve të huaja është realizuar në vlerën 118,316.059 mijë lekë ose 119% e fondit plan.